



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më 23.01.2020 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës Smajl Latifi: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni ti përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, Nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të Policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezentë këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë e që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, Përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSB-së, OSBE, përfaqësuesit e klerit fetar, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i parë për vitin 2020 i KKSB-së. Të pranishëm janë 23 anëtar të KKSB –së. Për këtë mbledhje propozoj këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
 - Analizë e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit për vitin paraprak,
 - Siguria në trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit
 - për Siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
3. Të ndryshme.

Kryetari – Ky rend dite, po ju vë në dijeni është në përputhje me planin e KKSB-së për vitin 2020, e qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryetari – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.

Kryetari - Në pikën e dytë të rendit të ditës të mbledhjes së KKSB-së, potencoi se gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën tonë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, gjithmonë flas duke u bazuar në bazë të informatave të cilat më vinë nga stacioni policor në Rahovec. Shpresoj se kjo të na përcjellë edhe në vijim dhe për këtë falënderoj së pari qytetarët e komunës së Rahovecit, policin e Kosovës dhe institucionet komunale. Ne në muajin dhjetor si komunë kemi marrë një vendim për mos përdorimin e mjeteve

piroteknike, posaçërisht në ato vende ku ka qarkullim të madhe të njerëzve, ky vendim ka ndikuar që mos të shiten vend e pa vend, kjo është bërë edhe fal punës së inspektoratit të komunës. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe në komunën tonë nuk ka pasur asnjë situatë të raportuar sa i përket incidenteve ndëretnike. Është mirë që ne si KKSB sot të i marrim disa vendime ose rekomandime sa i përket forcimit të sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit.

Fazli Morina - Komandanti i stacionit policor - Falënderoj kryetarin për bashkëpunimin e treguar me policin e Kosovës në vitin 2019, sa i përket sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit konstatoj se ka qenë e qetë dhe stabile si gjatë viti 2019, ashtu edhe në këto ditë të muajit janar të vitit 2020. Raporti i vitit 2019 për ne si stacion i policisë në Rahovec ka qenë i kënaqshëm edhe pse diku ka pasur rrënje diku ka pasur ngritje të veprave penale, por në përgjithësi është bërë një punë e mirë duke i përfshi të gjitha ato plane operative. Do i referohem në pika të shkurta për disa nga ngjarjet që kanë ndodhur në vitin e kaluar. Do i bëjë disa krahasime me vitin 2018, gjatë viti 2018 në stacionin policor në Rahovec kanë qenë të iniciuar gjithsej 524 raste, duke përfshi 374 vepra penale dhe 150 incidente. Kurse gjatë viti 2019 janë iniciuar gjithsej 547 raste, duke përfshirë 426 vepra penale dhe 121 incidente, ka pasur pak ngritje në këtë aspekt. Kurse sa i përket veprave të vjedhjeve të rënda, në vitin 2018 kanë qenë të iniciuara 95 raste, kurse në vitin 2019 kanë qenë 69 raste, pra ka një rrënje prej 27.37. Po ashtu edhe numri i incidenteve është në rrënje, në vitin 2018 kanë qenë 150, kurse në vitin 2019 kanë qenë 121. Gjithashtu siguria në trafik konsiderojmë se është në një gjendje më të mirë falë angazhimit të të gjitha njësive, si dhe me kërkesë të drejtorive komunale, shkollave, bizneseve, qytetarëve dhe juve si anëtar të KKSB-së. Sipas statistikave aksidentet me dëme materiale gjatë viti 2019 ka pasur rrënje nëse e krahasojmë me vitin 2018, në vitin 2018 kanë qenë 85 aksidente me dëme materiale në vitin 2019 ka rënë në 77 raste, pra diku rreth 18.95% ka rrënje. Kemi pasur edhe asistime gjithmonë sipas planeve operative në kuadër të stacionit të policisë nga drejtoria rajonale, si në gjykata, KEDSI, në Kuvendin Komunal, AKP-së etj. por ajo që ja vlen të përmendet dhe të diskutohet është lokalet e natës në fshatin Xërxë, ato munden të jenë shkas kryesor që në vitin 2019 të kemi 36 raste të raportuara nga më të ndryshmet. Prandaj si kërkesë e jona është që të rishikohet edhe një herë mundësia që këtyre lokaleve të natës të ju tërhiqet leja e punës prej 24 orëve ose ndryshe me orar të shtuar.

Shaip Shala - Përfaqësues i mediave lokale - I nderuari kryetar vendimi i juaj për ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike ka qenë një vendim me vend, në këtë vite është vërejtur se nuk ka pasur hedhje vend e pa vend dhe janë përdorur shumë më pak se viteve të kaluar. Po ashtu përgëzoj policin e Kosovës për punën e bërë gjatë vitit 2019, këtë vit kam vërejtur se rrugët e qytetit kanë qenë më të lira se sa në vitet e kaluara.

Fadil Sylka - Përfaqësues i komunitetit të bizneseve - Të nderuar mendoj se këtyre pronarëve të lokaleve të natës duhet që të ju bëhet një kushtëzim, nëse e përsërisin 3 herë gabimin e njëjtë atëherë të ju merret leja e punës prej 24 orëve.

Fazli Morina - I nderuar propozimi juaj është me vend, por unë jam që institucionet të veprojnë dhe të ju bëhen më shumë kontrole këtyre lokaleve të natës, po ashtu mbesë në propozimin time që të ju merret leja e punës prej 24 orëve.

Kryetari - Mendoj se duhet që të merren masa më të rrepta ligjore ndaj këtyre lokaleve të natës, këto lokale më shumë na sjellin kriminalitet se sa ndonjë dobi për qytetarët. Ne duhet të shikojmë ligjet që janë në fuqi dhe të ndërmarrim ndonjë masë, pra ne tani si KKSB duhet të votojmë dhe të marrim një vendim që ekzekutivi të ndërmerr masa sipas ligjit rreth aktiviteteve të këtyre lokaleve. Po ashtu unë kam edhe një propozim që pres edhe nga ju një përkrahje sepse edhe kjo ka të bëjë me këtë këshill, kishte me qenë mirë që të marrim së bashku një vendim që gjatë bartjes së arkivolit deri tek varrezat e qytetit,

njerëzit të cilët e përcjellin të vdekurin sipas traditës që e kemi të mos ecin si deri më tani rrugës kryesore por të devijohet rruga tek lagja e Sylka, me këtë do të lirohet qarkullimi i rrugës sepse mundemi të kemi ndonjë rast urgjent dhe rruga është e bllokuar dhe me këtë mundemi të kemi edhe ndonjë fatkeqësi tjetër, pres mbështetje edhe për këtë nga ju. E qes në votim propozimin që lokaleve të natës të ju kufizohet orari i punës ose të i tërhiqet leja e punës prej 24 orëve: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i anëtarëve të KKS-së, që leja e punës lokaleve të natës në pajtim me ligjet në fuqi në një afat optimal të i revokohet leja e punës.

Ylvi Shehu – Përfaqësues i Teqes së Madhe “Sheh Sylejmani” - I nderuari kryetar sa i përket propozimit për devijim të rrugës në rastet e përcjelljes së të vdekurin deri tek varrezat, është një propozim me vend. Por rruga të cilën ju e propozoni që të kalohet është me të vërtetë një rrugë e bllokuar nga vetë banorët e asaj lagje, pastaj kjo rrugë është vështirë e kalueshme sepse është shumë tatëpjetë, prandaj kishte me qenë mirë që së paku të ndërhyri që të lirohet kjo rrugë dhe nëse ka mundësi të rregullohet pakë që të ulët niveli i asaj rruge. Kurse si propozim edhe ne e përkrahim është një propozim me vend.

Nysret Abazibra – Krye imam i BI –së në Rahovec - I nderuari kryetar për t'u ekzekutuar ky vendim që do të del sot nga anëtarët e KKS-së është normale që do të dalin disa probleme, por mendoj se me rastin e marrjes së vendimit në formën e prerë besoj se do të merren parasysh të gjitha këto rrethana që u thanë deri më tani në mënyrë që ky vendim të ekzekutohet. Po ashtu dua të njoftoj këtë këshill sepse mendoj se është në dobi që ata të jenë të njoftuar, ne si BI në Rahovec kemi marrë iniciativën për ndërtimin e vend larjes për kufoma dhe morgut. Ky morg do të ketë kapacitet për ruajtjen deri në pesë 6 kufoma, ishalla nuk do të kemi asnjëherë këso raste, por ky është kapaciteti i këtij morgu. Mendoj se me këtë do të përfitojnë të gjithë qytetarët pa dallim nga komuna jonë, por në rast se ka nevojë edhe nga komunat e tjera kanë mundësi të sjellin kufoma në këtë morg. Mendojmë se me funksionalizimin e këtij objekti disa gjera edhe vetvetiu do të rregullohen sepse mendoj se pasi të rregullohet kufoma nuk do të ketë kërkesë që e njëjta kufomë të rikthehet qoftë në Xhami, qoftë në Teqe, por do të jetë mundësia e faljes së xhenazës në varreza. Por duhet të kuptohemi kjo është synim i zgjedhjes së nëse ata dëshirojnë, ne nuk ja ndalim të drejtën që ta marrin xhenazën dhe ta dërgojnë në objekte fetare. Neve si BI për deri sa jemi zbatues të marrëveshjes së shërbimeve të varrimit, ky lloj vendimi do të na shërbente shumë, ne besoni se edhe me vetë iniciativën tonë i kemi sugjeruar qytetarët që ta shfrytëzojnë këtë rrugë, por përderisa nuk ka pasur ndonjë vendim zyrtar as ne nuk kemi mundur të marrim vendim të prerë. Po ashtu me lejoni rastin që të përshëndes edhe iniciativën e komandantit të policës sa i përket kufizimit të punës së atyre lokaleve të natës, ne e mbështesim pa rezervë propozimin e tij, ne këtë çështje do e ngrisim edhe në tubimet tona që i kemi sepse pa dyshim që është vendim i cili do i shërbejë për të mirë të gjithë qytetarëve.

Sabahudin Durguti – Përfaqësues i Teqes “Haxhi Sheh Iliaz Shehu” - I nderuari kryetar desha vetëm të ndërlidhem me parafolësit e mij sa i përket shfrytëzimit të rrugës së propozuar te lagja Sylka, jam pro këtij propozimi, por ju kisha lutur i nderuari kryetar që kjo rrugë të mirëmbahet posaçërisht në kushtet e dimrit.

Fazli Morina - Ne e përkrahim këtë propozim dhe është shumë me vend,, ajo që na shqetëson neve është se ne rrugën kryesore te varrezat po kemi shumë automjete të parkuara në shiritin qarkullues, pra në rrugën kryesore, ne shpesh herë jemi duke asistuar në atë rrugë ku bëjmë zhbllokim e kësaj rruge, por disa qytetarë kurrë nuk do të vetëdijesohen, ngushëllime për familjarët por ne për të vdekurin tani nuk mundemi të japim të gjallin. Mund të ketë nevojë që ndonjë ndihmë e shpejtë të vijë nga kjo rrugë në drejtim të Prishtinës dhe të mos ketë mundësi të kalojë.

Kryetari - I dëgjova diskutimet tuaja, të nderuar ne kemi një problem goxha serioz në rrugën Rahovec – Suharekë, ne nuk po kemi mundësi të zgjerojmë këtë rrugë, së paku në njërën anë, kjo na kishte ndihmuar shumë. Me këtë nuk do ishte bërë ajo tollovi sepse njëra anë ishte shfrytëzuar për njerëz që e përcjellin arkivolin dhe makinat kishin lëvizur lirshëm. Ne kemi tentuar por nuk kemi pas mundësi sepse aty janë varrezat dhe nuk ka pas vend për shtimin e një shiriti, në momentin që ka kushte për zgjerim të asaj rruge ne jemi aty për të kryer këtë. Tani të nderuar anëtarë të KKSB-së e qes në votim propozimin për devijim të rrugës nga ana e xhematit në ato raste kur bëhet përcjellja e kufomës për në varrezat e qytetit: Konstatohet se në mënyrë unanime është votuar nga ana e anëtarëve të KKSB - së. Kërkoj nga policia dhe inspektorati i komunës që të inspektojnë të ashtuquajturat varrezat e automjeteve që janë në komunën tonë, posaçërisht ato në rrugën kryesore Rahovec – Xërxë, të shikohet se a kanë pëlqim nga ministria përkatëse, sepse ata pasi i kalojnë më shumë se 20 makina janë në kompetencë të ministrisë e jo komunës. Po ashtu të nderuar anëtarë të KKSB-së po ju njoftoj se në një afat optimal do të bëjmë pastrimin e vendit si të tregut të gjelbër, pastaj objektet e vjetra që të ish Podrimës dhe parkingu të parku. Ne jemi në procedura të përpilimit të një plani për ndërtimin e sheshit të qytetit dhe këto pjesë do të jenë pjesë të këtij projekti.

Fadil Sylka - I nderuari kryetar ndoshta kishte me qenë më mirë që të nxjerrët një rregullore nga Kuvendi i Komunës ku do të caktohen kushtet për hapje të një biznesi të këtij lloji, e jo të shkohet drejtpërsëdrejti pa mbështetje ligjore.

Kryetari - I nderuari z. Fadil Sylka ka ligje dhe udhëzime sa i përket procedurave të hapjes së një biznesi të këtillë, por ju si përfaqësues i biznesit duhet të shkoni te ta dhe t'ua bëni me dije që kjo nuk është në rregull, pra nëse duhet edhe ne do vijmë me ju pra së bashku të shkojmë t' i vizitojmë këto biznese. Juve si përfaqësues ju takon që të merrni këso veprime ku do t' i njoftoni me rrezikshmërinë që janë duke bërë ata me hapjen e këtyre varrezave në vendet ku nuk janë të përshtatshme sepse rrezikojnë jetën e qytetarëve.

Fadil Sylka - I nderuari kryetar unë nuk jam pro këtyre bizneseve që shkelin ligjin, jam absolutisht kundra tyre, nuk i mbroj fare këto biznese ta keni të qartë këtë.

Mensur Harizi – Përfaqësues i FSK-së - Pasi u përmend siguria në shkollat ne si FSK e kemi një planprogram për vitin 2020, ku jemi duke e realizuar disa trajnime në shkollat e komunës së Republikës së Kosovës. Fatkeqësisht për vitin 2019 komuna e Rahovecit nuk ka qenë pjesë e këtij projekti, por për vitin 2020 është zgjedh si komunë me prioritet, ku do të mbajmë ligjërata në shkollat e mesme për vetëdijesimin nga minat, ne shpresojmë se do të koordinohemi me DKA-në e Rahovecit ku do të caktojmë se në cilat shkollat saktë do të mbahen këto ligjërata. Po ashtu ne do të mbajmë ligjërata ndaj tërmeteve ose fatkeqësive natyrore, ne kemi dalë nëpër shkollat dhe kemi parë që nuk janë funksionale daljet emergjente, pastaj në ato vende ku ka dalje emergjente nuk ka shenja që tregojnë dalje emergjente, prandaj e kemi si urgjent këtë lloj trajnime në shkollat. Të nderuar anëtar të KKSB-së nëse keni ndonjë kërkesë për ne sa i përket sigurisë si në shkollat apo çfarëdo institucioni ju lutem na përcillni në mënyrë që ne t' i adresohemi institucioneve tona më lartë.

Kryetari - Ju falënderoj për diskutimin e bërë sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, kalojmë në pikën e radhës:

3. Të ndryshme.

Ramë Berisha – Përfaqësues i komunitetit ashkali - Desha vetëm ta përshëndes kryetarin e komunës dhe t'ia përcjelli një përshëndetje nga lagja ku jetoj unë dhe komunitetet tjera si jo shumicë edhe shumicë. Kryetari na ka premtuar ndërtimin e një rrugë në këtë lagje dhe e ka mbajtur premtimin, prandaj ne si lagje e përshëndesim këtë veprim të kryetarit Latifi.

Kryetari – Tani të nderuar do të marrim disa konkluzione sa i përket kësaj mbledhje: Kërkoj nga policia dhe inspektorati i Komunës së Rahovecit që të vazhdojnë me kontroll dhe me lirime të trotuareve si nga mallrat e ekspozuara ashtu edhe nga makinat, fokus të veçantë në rrugën “Gëzim Hamza – Piktori”, në këtë pjesë kemi shumë ankesa nga qytetarët. Të ndërmerren masa ndaj shkelësve të ligjit të cilët rezistojnë vendimet e komunës. Të inspektohen nga inspektorati i komunës varrezat e makinave të vjetra dhe hekurishteve, të shikohet leja e punës së tyre. Të nderuar me kaq përfundon mbledhja e sodit, ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë mbledhje, shihemi në mbledhjet e radhës.

Mbledhja përfundoi në 11:50


Procesmbajtës
Skender Hamza


Kryetari i Komunës
Smajl Latifi